



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
USTAVNI SUD
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 6 shkurt 2023
Nr. ref.:RK 2118/23

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI93/22

Parashtrues

Jovan Ristić

Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Supreme, Rev. nr. 459/21, të 21 prillit 2022, në lidhje me Aktvendimin e Gjykatës së Apelit [Ac. nr. 2580/20], të 8 prillit 2021

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Gresa Caka-Nimani, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar
Enver Peci, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga Jovan Ristić me vendbanim në fshatin Livoq Epërm, Komuna e Gjilanit, i cili përfaqësohet nga Skender Zenuni nga Gjilani (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës e konteston Aktvendimin [Rev. nr. 459/21] të 21 prillit 2022 të Gjykatës Supreme në lidhje me Aktvendimin e Gjykatës së Apelit [Ac. nr. 2580/20] të 8 prillit 2021.
3. Parashtruesi i kërkesës, Aktvendimin e Gjykatës së Apelit [Ac. nr. 2580/20] të 8 prillit 2021, e ka pranuar më 27 korrik 2021.

Objekti i çështjes

4. Objekti i çështjes së kësaj kërkesë është vlerësimi i kushtetutshmërisë së vendimit të kontestuar, me të cilin parashtruesi i kërkesës pretendon shkeljen e të drejtave të tij të garantuara me nenet 24 [Barazia para Ligjit] dhe 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta) në lidhje me nenin 1 të Protokollit 1 (Mbrojtja e Pronës) të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNJ).

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në paragrafët 1 dhe 7, të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenin 22 [Procedimi i kërkesës] dhe 47 [Kërkesat individuale] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullin 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] dhe 59 [Llojet e vendimeve] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

6. Më 21 qershor 2022, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi përmes Postës kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
7. Më 7 korrik 2022, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Safet Hoxha gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Selvete Gërxhaliu- Krasniqi (kryesuese) Remzije Istrefi Peci dhe Nexhmi Rexhepi, anëtarë.
8. Më 5 korrik 2022, Gjykata njoftoi parashtruesin e kërkesës për regjistrimin e kërkesës si dhe kërkoi saktësimin e kërkesës dhe plotësimin e formularit.
9. Më 4 gusht 2022, parashtruesi i kërkesës dorëzoi plotësimet e kërkuara në Gjykatë.
10. Më 12 shtator 2022, Gjykata njoftoi Gjykatën Supreme për regjistrimin e kërkesës dhe të njëjtës i ofroi një kopje të saj.
11. Më 3 nëntor 2022, kërkoi nga Gjykata Themelore që të bashkëlidhte fletëkthesën për dëshminë se kur parashtruesi i kërkesës e kishte pranuar Aktvendimin e Gjykatës së Apelit.
12. Më 25 nëntor 2022, Gjykata Themelore dorëzoi në Gjykatë fletëkthesën ku theksohej që parashtruesi i kërkesës e kishte pranuar Aktvendimin e Gjykatës së Apelit më 27 korrik 2021.
13. Me 16 dhjetor 2022, gjyqtari Enver Peci dha betimin para Presidentes se Republikës së Kosovës, me ç' rast filloi mandati i tij në Gjykatë.

14. Më 17 janar 2023, Kolegji Shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

15. Më 17 prill 2020, parashtruesi i kërkesës dorëzoi një parashtrësë në Gjykatën Themelore, e cila në analizën e Gjykatës Themelore nuk ishte e qartë, rrjedhimisht më 21 prill 2020, gjyqtari i çështjes e ktheu të njëjtën në plotësim, duke e udhëzuar se si te veproj në bazë të dispozitave të Ligjit të Procedurës Kontestimore (në tekstin në vijim: LPK).
16. Më 24 prill 2020, i autorizuari i parashtruesit të kërkesës dorëzoi një parashtrësë, ku theksonte se si paditës ka paraqitur personin Jovan Ristiq, ndërsa si të paditur Kuvendin Komunal në Gjilan-Drejtoria për Urbanizëm, kurse objektin e kontestit e ka paraqitur si pengim posedim.
17. Më 24 prill 2020, Gjykata Themelore përmes Aktvendimit [C.nr.753/20] (I) hodhi poshtë parashtrësë e 17 prillit 2020 të paraqitur nga parashtruesi i kërkesës kundër të paditurit Kuvendi Komunal në Gjilan-Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim e Mbrojtje te Mjedisit; (II) Secila pale i bart shpenzimet e veta të procedurës.
18. Në arsyetimin e Aktvendimit të lartcekur, Gjykata Themelore theksoi si në vijim:

“Gjykata duke vlerësuar parashtrësën e dt.24.04.2020, erdhi në përfundim se e njëjta parashtrësë-padi nuk i përmbush elementet e parapara në nenin 253 të LPK-së, për përmbajtjen e nenin 253), kur themi këtë e kem parasysh se paditësi, përkatësisht i autorizuari i tij vetëm përshkruar se paditësi është pronarë i ngastrave nr.00359-0 dhe 00361-0 dhe përshkruan se kush ka dalë në vend ngjarje, si kanë biseduar me të paditurën (por të njëjtit nuk kanë qenë të vullnetit të mirë), etj etj, por askund nuk e shohim që paditësi ka paraqitur fakte, prova për vërtetim e fakteve (përveç që është pronarë i ngastrave kontestuese), kurse kur vim te kërkesëpadija është shumë e pakjartë se çfarë kërkon, pasi qe përmbajtjen e padisë i njëjti flet për pengim posedim, kurse kërkon që e paditura të paguaj dëmin (cilin dëm dhe kush e ka shkaktuar apo si e ka shkaktuar, nuk dihet), e gjithashtu ka kërkuar që e paditura të paguaj për 500 m2, në vlerë prej 15.000 (d.m.th. asnjë fakt e provë për dëmin e pretenduar nuk ka paraqitur, e gjithashtu asnjë fakt e provë për kërkesën sa i përket pagesës për 500 m2 në shumë prej 15.000 (nuk ka paraqitur, d.m.th. sa i përket padisë, paditësi nuk i është përmbajtur nenit 253 të LPK-së, edhe për kundër se i është kërkuar me Akt.C.nr.753/20, dt.21.04.2020.

[...]

[...] parashtrësën e datës 24.04.2020, aspak nuk i është përmbajtur kërkesës së gjykatës, përkatësisht i njëjti ka dështuar të zbatoj standardet ligjore të përcaktuara nga LPK-ja, për padinë si dhe për propozimet për masa siguruese, andaj për këto arsye (të shpjeguara si më lartë dhe bazuar në nenin 102.3 të LPK-së, erdhi në përfundim se parashtrësja e paditësit dt.17.04.2020 duhet të hidhet poshtë dhe vendosi si në pikën I të dispozitivit.”

19. Kundër Aktvendimit të lartcekur parashtruesi i kërkesës në afat ligjor paraqiti ankesë për shkak të shkeljeve të dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të aprovohet në tërësi ankesa si dhe të priset Aktvendimi i Gjykatës

Themelore dhe lënda ti kthehet të njëjtës gjykatë në vendosje meritore. Në anën tjetër edhe pala e paditur – Komuna e Gjilanit paraqiti përgjigje në ankesë.

20. Më 8 prill 2021, Gjykata e Apelit përmes Aktvendimit [Ac.nr. 2580/20] refuzoi si të pathemeltë ankesën e parashtruesit të kërkesës, ndërsa vërtetoi Aktvendimin e Gjykatës Themelore. Në arsyetimin e Aktvendimit të saj, Gjykata e Apelit ndër të tjerash theksoi si në vijim:

Gjykata e shkallës së parë drejtë ka vendosur kur e ka hedhur poshtë parashtrësën e paditësit, kjo nga fakti se konform dispozitave ligjore, gjykata ia ka dërguar aktvendimin C.nr.753/20 të dt. 21.04.2020 me të cilin paditësit iu është kthyer në plotësim parashtrësja e dt. 17.04.2020, që në afat prej 3 ditësh nga dita e marrjes së aktvendimit të plotësojë të njëjtën, duke treguar se parashtrësja e lartcekur a është padi. propozim për caktimin e masës së përkohshme apo siguruese për sigurimin e kërkesëpadisë, e që udhëzohet të plotësojë parashtrësën konform dispozitave ligjore të LPK-së. [...]

Në rastin konkret gjykata e shkallës së parë i ka ndërmarrë të gjitha veprimet duke i dërguar paditësit aktvendimin për plotësimin e padisë, duke ia sqaruar në mënyrë të saktë dhe të qartë se si të veprojë, duke e njoftuar edhe për pasojat ligjor të mosveprimit Konform dispozitave ligjore të LPK-së. por që pala paditëse përkundër faktit që e ka autorizuar me dt. 22.04.2020 juristin e diplomuar Skender Zenuni, nga Biro Juridike, Shërbime Juridike, JUS Civile i cili duhet të jetë profesionist dhe të veprojë sipas ligjit, i njëjti prapë se prapë nuk e ka plotësuar padinë konform dispozitave ligjore të LPK-së.

21. Më 5 gusht 2021, parashtruesi i kërkesës dorëzoi kërkesë për revizion kundër Aktvendimit të lartcekur, për shkak të cenimit të rëndë të dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të pranohet revizioni, ndërsa Aktvendimi i shkallës së parë të refuzohet si i pabazuar dhe të detyrohet e paditura ta kompensoj vlerën e pronës me të cilën parashtruesi i kërkesës nuk disponon me atë pjesë.
22. Më 21 prill 2022, Gjykata Supreme përmes Aktvendimit [Rev.nr.459/21] hodhi poshtë si të palejuar revizionin e paditësit, të paraqitur kundër Aktvendimit të Gjykatës së Apelit. Në arsyetimin e Aktvendimit të saj Gjykata Supreme theksoi si në vijim:

Gjykata Supreme e Kosovës duke vlerësuar kërkesën nga parashtrësja e datës 17.04.2020, që ka të bëjë me masë të përkohshme apo masë të sigurisë si dhe parashtrësën e datës 24.04.2020, që ka të bëjë me çështjen e pengimit të posedimit, vlerëson se në kontestet e tilla qoftë nga masa e sigurisë apo e pengimit të posedimit revizioni është i palejueshëm.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

23. Parashtruesi i kërkesës e konteston Aktvendimin [Rev. nr. 459/21] e 21 prillit 2022 të Gjykatës Supreme, me pretendimin se i njëjti është nxjerrë në shkelje të të drejtave dhe lirive themelore të tij të garantuara me nenet 24 [Barazia para Ligjit] dhe 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës, në lidhje me nenin 1 të Protokollit 1 (Mbrojtja e Pronës) të KEDNJ-së.
24. Parashtruesi i kërkesës në thelb pretendon që Gjykata Themelore nuk e shqyrtoi padinë e tij e cila i përmbante elementet ligjore të LPK-së. Pra, parashtruesi konsideron se “e

paditura – Komuna e Gjilanit [theksim i shtuar] nuk ka vepruar konform dispozitave ligjore të nenit 7 paragrafit 7.3.4.1 dhe veprimet tjera procedurale siç e parasheh ligji nr. 03/L-139 për shpronësimin e pronës së paluajtshme, por se në mënyrë të njëanshme dhe në kohën e pandemisë COVID-19 është marrë vendim pa prezencën e qytetarëve për veprimet e ndërmarrë në rastin konkret nga e paditura.”

25. Rrjedhimisht, parashtruesi i kërkesës pretendon shkelje esenciale të dispozitave ligjore të paraparë në nenin 24 lidhur me neni 46 të Kushtetutës në harmoni me Konventën Evropiane për të drejtat e njeriut.
26. Përfundimisht, parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata që të nxjerr Aktvendim përmes të cilit: (I) Aprovohet në tërësi si e bazuar ankesa kushtetuese e parashtruesit të kërkesës; (II) obligohet e paditura të zbatojë dispozitat ligjore të Ligjit Nr. 03/L-139 lidhur me nenin 46 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës në harmoni me nenin 1 të Protokollit shtesë të KEDNJ-së.

Dispozitat relevante kushtetuese ligjore

Kushtetuta e Republikës së Kosovës

Neni 24 [Barazia para Ligjit]

1. *Të gjithë janë të barabartë para ligjit. Çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes së barabartë ligjore, pa diskriminim.*
2. *Askush nuk mund të diskriminohet në bazë të racës, ngjyrës, gjinisë, gjuhës, fesë, mendimeve politike ose të tjera, prejardhjes kombëtare a shoqërore, lidhjes me ndonjë komunitet, pronës, gjendjes ekonomike, sociale, orientimit seksual, lindjes, aftësisë së kufizuar ose ndonjë statusi tjetër personal.*
3. *Parimet e mbrojtjes së barabartë ligjore nuk parandalojnë vënien e masave të nevojshme për mbrojtjen dhe përparimin e të drejtave të individëve dhe grupeve që janë në pozitë të pabarabartë. Masat e tilla do të zbatohen vetëm derisa të arrihet qëllimi për të cilin janë vënë ato.*

Neni 46 [Mbrojtja e Pronës]

1. *E drejta e pronës është e garantuar.*
2. *Shfrytëzimi i pronës rregullohet me ligj, në pajtim me interesin publik.*
3. *Askush nuk do të privohet në mënyrë arbitrare nga prona. Republika e Kosovës ose autoriteti publik i Republikës së Kosovës mund të bëjë ekspropriimin e pronës nëse ky ekspropriim është i autorizuar me ligj, është i nevojshëm ose i përshtatshëm për arritjen e qëllimit publik ose përkrahjen e interesit publik, dhe pasohet me sigurimin e kompensimit të menjëhershëm dhe adekuat për personin ose personat prona e të cilave ekspropriohehet.*
4. *Kontestet që lindin nga akti i Republikës së Kosovës ose autoritetit publik të Republikës së Kosovës për të cilat pretendohet se përbëjnë ekspropriimin, do të zgjidhen nga gjykata kompetente.*
5. *Prona intelektuale mbrohet me ligj.*

Pranueshmëria e kërkesës

27. Gjykata së pari vlerëson nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuar më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës.
28. Në këtë drejtim, Gjykata, fillimisht, i referohet nenit 113.1 dhe 113.7 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, i cili përcakton:

Neni 113

“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

29. Gjykata, më tej, i referohet neneve 47 [Kërkesa individuale], dhe 48 [Saktësimi i kërkesës], të cilët përcaktojnë:

Neni 47 [Kërkesa individuale]

“1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tija individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.

2. Individ i mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”

Neni 48 [Saktësimi i kërkesës]

Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj.

30. Për sa i përket përmbushjes së këtyre kriterëve, Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar, i cili konteston një akt të një autoriteti publik, përkatësisht Aktvendimin e Gjykatës Supreme [Rev. nr. 459/21] të 21 prillit 2022, pasi i ka shteruar mjetet juridike të parapara me ligj.
31. Megjithatë, Gjykata shqyrton nëse janë përmbushur kriteret e përcaktuara me nenin 49 [Afatet] të Ligjit dhe rregullin 39 [Kriteret e pranueshmërisë], respektivisht paragrafin (1) (c) të Rregullores së punës. Ato përcaktojnë si në vijim:

Neni 49 i Ligjit [Afatet]

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor...”

Rregulli 39 i Rregullores së punës

[Kriteret e pranueshmërisë]

“(1) Gjykata mund ta konsiderojë një kërkesë të pranueshme nëse:

[...]

c) kërkesa parashtrohet brenda katër (4) muajsh nga dita kur vendimi i mjetit të fundit efektiv juridik i është dorëzuar parashtruesit, dhe [...].”

32. Në lidhje me sa u tha më sipër, Gjykata rikujton se afati 4 (katër) muaj fillon nga “vendimi i fundit” në procesin e shterjes së mjeteve juridike me të cilin është refuzuar ankesa e parashtruesit (shih *mutatis mutandis*, rastin e Gjykatës Kushtetuese: KI120/17, parashtrues: *Hafiz Rizahu*, Aktvendim për papranueshmëri, i 7 dhjetorit 2017, paragrafi 30; si dhe rastin e GJEDNJ-së, *Paul dhe Audrey Edwards kundër Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 46477/99, Vendim i 14 marsit 2002).
33. Gjykata rikujton po ashtu se parashtruesi i kërkesës duhet t’i shterojë të gjitha mjetet juridike të cilat pritet të jenë efektive dhe të mjaftueshme. Vetëm mjetet efektive mund të merren parasysh nga Gjykata, pasi parashtruesi i kërkesës nuk mund të zgjasë afatet kohore strikte të parapara me Ligj dhe Rregullore të punës, duke u përpjekur të ushtrojë mjete juridike që nuk janë të lejuara ose duke u ankuar në institucionet të cilat nuk kanë kompetencë që të ofrojnë mbrojtje të të drejtave për të cilat ankohet parashtruesi i kërkesës (shih, *mutatis mutandis*, rastet e Gjykatës Kushtetuese: KI120/17, parashtrues *Hafiz Rizahu*, Aktvendim për papranueshmëri, i 7 dhjetorit 2017, paragrafi 31; KI112/19, parashtrues *Illir Kabashi*, Aktvendim për papranueshmëri, i 2 dhjetorit 2019, paragrafi 38; si dhe rastin e GJEDNJ-së, *Fernie kundër Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 14881/04, Vendim i 5 janarit 2006).
34. Gjykata vëren se procedura ndaj parashtruesit të kërkesës e zhvilluar para gjykatave të rregullta në lidhje me kërkesën e tij, kishte përfunduar me Aktvendimin e Gjykatës së Apelit [Ac. nr. 2580/20] të 8 prillit 2021, përmes së cilit ishte refuzuar ankesa kundër Aktvendimit të Gjykatës Themelore.
35. Më tej, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës paraqiti edhe kërkesën për revizion në Gjykatën Supreme, duke pretenduar shkelje të dispozitave të procedurës dhe të së drejtës materiale.
36. Në bazë të arsyetimit të Gjykatës Supreme, Gjykata vëren se në pajtim me Aktvendimin e Gjykatës Supreme, parashtruesi i kërkesës ka përdorur mjet juridik të palejuar në procedurën respektive.
37. Prandaj, Gjykata gjen se për shkak të vetë faktit se parashtruesi i kërkesës nuk e vazhdoi procedurën gjyqësore me mjetin juridik i cili ka qenë në dispozicion në çdo kohë, ai i ka kontribuar faktit se Gjykata Supreme nuk ka mundur të vazhdojë me vërtetimin e bazueshmërisë së pretendimeve të tij ankimore (shih rastin e Gjykatës Kushtetuese: KI76/17, parashtrues *Nysret Fana* dhe të tjerët, Aktvendim për papranueshmëri, i 10 prillit 2018, paragrafi 57).
38. Për më tepër, Gjykata rikujton se, në rastin e parashtruesit të kërkesës, pas pranimit të Aktvendimit të Gjykatës së Apelit [Ac. nr. 2580/20] të 8 prillit 2021, asgjë nuk e ka ndaluar atë t’i drejtohet Gjykatës Kushtetuese. Megjithatë, ai ka përdorur mjete juridike, si revizionin kundër Aktvendimit të Gjykatës së Apelit, i cili nuk kanë qenë i paraparë me ligj.

39. Rrjedhimisht, si “vendim i fundit”, sipas nenit 49 të Ligjit është Aktvendimi i Gjykatës së Apelit [Ac. nr. 2580/20] i 8 prillit 2021, me të cilin ishte refuzuar ankesa e parashtruesit të kërkesës dhe i cili ishte i paapelueshëm (shih rastet e Gjykatës Kushtetuese nr. KI112/19, parashtrues *Ilir Kabashi*, Aktvendim për papranueshmëri, i 2 dhjetorit 2019, paragrafi 43; KI23/19, parashtrues *Agim Hoxha*, Aktvendim për papranueshmëri, i 29 tetorit 2021, paragrafi 93).
40. Andaj, Gjykata rikujton se Aktvendimi i Gjykatës së Apelit [A Ac. nr. 2580/20], ishte nxjerrë më 8 prill 2021. Në bazë të fletkthesës e cila ndodhet në dosjen e rastit shihet që parashtruesi i kërkesës, Aktvendimin e Gjykatës së Apelit e ka pranuar më 27 korrik 2021 dhe me këtë Gjykata vëren se koha në mes të pranimit të aktvendimit dhe të datës së dorëzimit të kërkesës së tij, më 21 qershor 2022, në Gjykatë ka kaluar periudhën kohore prej 4 (katër) muajsh.
41. Rrjedhimisht, Gjykata konkludon se kërkesa e parashtruesit të kërkesës në lidhje me Aktvendimin e Gjykatës së Apelit [Ac. nr. 2580/20] të 8 prillit 2021, është dorëzuar pas afatit ligjor prej 4 (katër) muajsh.
42. Gjykata rikujton se qëllimi i afatit ligjor prej 4 (katër) muajsh, sipas nenit 49 të Ligjit dhe sipas rregullit 39 (1) (c) të Rregullores së punës, është që të promovojë siguri juridike, duke siguruar që rastet që kanë të bëjnë me çështje kushtetuese të trajtohen brenda një periudhe të arsyeshme dhe të parandalohet mbajtja në gjendje pasigurie për një periudhë të gjatë kohore e palëve dhe personave të tjerë të përfshirë në procese gjyqësore (shih Aktgjykimin e GJEDNJ-së *Mocanu dhe të tjerët kundër Rumanisë*, kërkesat nr. (10865/09, 45886/07 dhe 32431/08), të 17 shtatorit 2014, paragrafi 258; shih, gjithashtu Aktgjykimin e GJEDNJ-së *Lopes de Sousa Fernandes kundër Portugalisë*, nr. 56080/13, të 19 dhjetorit 2017, paragrafi 129; dhe, rastin e Gjykatës Kushtetuese nr. KI112/19, parashtrues *Ilir Kabashi*, Aktvendim për papranueshmëri, i 2 dhjetorit 2019, paragrafi 46).
43. Ky afat gjithashtu i mundëson parashtruesit potencial të kërkesës që të shqyrtojë nëse dëshiron të paraqesë kërkesë dhe, nëse dëshiron, të vendosë për ankesat dhe argumentet konkrete që duhet ngritur dhe në të njëjtën kohë lehtëson vërtetimin e fakteve në këtë rast, meqë me kalimin e kohës, çdo shqyrtim i drejtë i çështjeve të ngritura bëhet problematik (shih Aktgjykimin e GJEDNJ-së *Sabri Güneş kundër Turqisë*, kërkesa nr. 27396/06, të 29 qershorit 2012, paragrafi 39; shih po ashtu edhe rastin e Gjykatës KI12/20, parashtruese e kërkesës *Hamijete Dinarama-Daija*, Aktvendim për papranueshmëri, i 6 nëntorit 2020, paragrafi 42).
44. Ky rregull specifikon afatin kohor për kontrollin e ushtruar nga Gjykata dhe paralajmëron individët dhe autoritetet shtetërore për afatin pas të cilit kontrolli i tillë nuk është më i mundur (shih Vendimin e GJEDNJ-së *Walker kundër Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 34979/97, të 25 janarit 2000; shih, gjithashtu, Aktgjykimin e GJEDNJ-së, *Sabri Güneş kundër Turqisë*, të cituar më lart, paragrafi 40; shih po ashtu edhe rastin e Gjykatës KI53/18, parashtrues i kërkesës *Hajri Ramadani*, Aktvendimi për papranueshmëri, i 6 dhjetorit 2018, paragrafi 45).
45. Andaj, mbi bazën e arsyetimeve të mësipërme, Gjykata konkludon se kërkesa e parashtruesit të kërkesës është dorëzuar jashtë afatit ligjor të përcaktuar me nenin 49 të Ligjit dhe me rregullin 39 (1) (c) të Rregullores së punës, dhe si e tillë është e papranueshme.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, me nenin 49 të Ligjit dhe në pajtim me rregullin 39 (1) (c) të Rregullores së punës, më 17 janar 2023, njëzëri:

VENDOS

- I. TË DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TË PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues

Safet Hoxha



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese

Gresa Caka-Nimani